- (28) Sing, W.S. 2003.: *Red reishi*. World Health Publishing Inc., Vancouver, 55.
- (29) Sliva, D. (2004): Cellular and physiological effects of *Ganoderma lucidum*. *Mini Rev Med Chem.* Oct; 4(8): 873–9.
- (30) Stamets, P. (2000): *Growing Gourmet and Medicinal Mushrooms*, Third Edition, Ten Speed Press, Berkeley, Toronto
- (31) Zhang, J. et al (2002): Activation of B lymphocytes by GLIS, a bioactive proteoglycan from *Ganoderma lucidum*. *Life Sciences*, (71) 623–638.
- (32) Wasser, S.P. (2002): Medicinal mushrooms as a source of antitumor and immunomodulating polysaccharides. *Appl. Microbiol Biotechnol.* 60: 258–274.
- (33) Wasser, S.P., Didukh Mya (2004): *Dietary Supplements from Culinary-Medicinal Mushrooms: A Variety of Regulations and Safety Concerns for the 21st Century* *International Journal of Medicinal Mushrooms* Volumes 3.
- (34) Zaidman, B.Z., Yassin, M., Mahajna, J., Wasser, S.P. (2005): Medicinal mushroom modulators of molecular targets as cancer therapeutics. *Appl Microbiol Biotechnol.* Feb. 23.



Dr. Terezia Samu
Soaring menaxhere





TRAINIME GRUPESH FLP-JE

Ofertë me ulje çmimi

*strehim për 2 ditë, 1 natë dy vakte kryesore (drekë, darkë),
mëngjes me tryezë suedeze shërbimet bazë të sektorit SONYA wellness
(sauna, kabinë kripe, pishina me rrymë të kundërt, xhakuzi)
përdorim i fushës së tenisit*

15.000.-Ft/person

*Në sektorin SONYA punonjësit e FLP-s mund
të marrin në përdorim edhe trajtime të ndryshme kozmetike dhe masazhe me 50% ulje çmimi!*

*Trainimet organizohen në sallën Ovidius.
Rregullimi i orendive dhe pajisjeve teknike
bëhet sipas kërkesave të porositësit.*





FOLEJA E SHQIPONJAVE, RESTORANTI I FOREVER-IT!

Ha drekë dhe darkë tek ne, ju presim me zgjedhje të larmishme dhe çmime të favorshme! Organizojmë tek ne takimet e tua, këtu mund ta ndërtosh biznesin tënd në një ambient të qetë e të këndshëm pranë një kafeje apo çaji të ngrohtë!



**JE I FTUAR
TEK NE**
PËR NJË UJË MINERAL SIRONA
OSE NJË KAFE EKSPRES!*



* Deri në 30 shtator për çdo ushqim të ngrënë sipas dëshirës suaj ju japim falas një ujë mineral Sirona ose kafe ekspres!

Bëmë VETËM DETYRËN TONË

Me diamant-safir menaxherët Aranka Vagasi és Andras Kovacs flasim kur ata ndodhen në vijën e nisjes: së shpejti niset avioni i tyre për në Amerikë. Më saktë jo i tyre, por i skuadrës së tyre. Dhe kjo është kështu në gjithçka; ata të dy nuk mund të kuptohen pa skuadrën e tyre – ndoshta çifti më „familjar“ në FLP.

Kujdo që i thashë që do të përgatis intervistë me familjen e Arankës, dhe u interesova se çfarë u interesonte në lidhje me ta, njerëzit në mënyrë të natyrshme m'u përgjigjën: sporti. Dhe këtu nuk mendojmë vetëm që bëhet fjalë për sportistë me medalje kampionësh bote, por edhe për punën rrjetndërtuese profesioniste që i ngjan sportit profesionist. Por ku ngjajnë këto?

Andras Kovacs: Në të dyja është e rëndësishme gara. Secila ka të bëjë me rendimentin, vetëm që njëra matet me metra ose me gola, kurse tjetra me pikë. Veprimtaria sportive dhe puna jonë ndahet në pjesë: të dyja kanë një periudhë që të sjell në formë dhe një periudhë tjetër që të mban në formë. Nëse përgatitja bëhet siç duhet, atëherë mund të ndërtohet pa frikë. Në fillim rritja vjen në mënyrë spontane. Por kur vijnë vështirësitë, atëherë del në pah rëndësia e diturisë. Dhe për të dyja fushat është e vërtetë që profesionist quhet vetëm ai që është në gjendje ta ruaj nivelin e mirë edhe në rastin e ndryshimit të kushteve të jashtme.

Aranka Vagasi: Edhe në Forever ka periudha kulminante: marsi, gushti dhe tetori, si dhe finishi i dhjetorit për një rreth të ngushtë. Ritmi është i dhënë, dhe bashkë me të edhe detyra: sjellje konskuente, përbalje disfatash, këmbëngulje, ndërtim skuadre. Nëse shkon përpara duke dhënë shembull, u tregon të tjerëve që rruga mund të përshkohet, atëherë ata do të ndjekin.

A.K.: Por ekziston paralelizmi edhe ndërmjet Forever-it dhe profesionit tonë të mëparshëm të pedagogut. Nëse në atë kohë përshembull merrnim një klasë të re, duhet të njiheshim me anëtarët e saj, të shikonim nivelin e diturisë së tyre dhe të merrnim masat e nevojshme për suksesin e tyre. Edhe këtu bëjmë të njëjtën gjë. Njohuri, rutinë, aftësi dhe mundësi: në këto duhet të arrijmë nivelin maksimal.

A.V.: Secili vjen me një rekord personal dhe zhvillohet me ritëm të ndryshëm. Duhet të përparojmë edhe individualisht, edhe në skuadër, pasi anëtarët e skuadrës kanë efekt mbi njëri tjetrin.

Mund të ndikojnë edhe negativisht mbi njëri tjetrin.

A.V.: Çdo efekt është negativ nëse nuk je në gjendje ta trajtosh. Gjëra të tillë duhen llogaritur gjithmonë. Për fat të mirë të dy dimë të luajmë shah, kështu që jemi gjithmonë dy hapa përpara.

Jeni „mësues“ të rreptë?

A.K.: Unë si mësues nuk kam ngelur kurrë, për mua s'ka patur kurrë fëmijë të keq, vetëm të lëvizshëm. Duhet të gjeja njeriun e duhur dhe të ndërtoja skuadrën rreth tij.

A.V.: Edhe sot bëjmë të njëjtën gjë: kërkojmë personat e zotë, të aftë dhe komunikativ, mbi të cilët mund të ndërtohet. Është e vështirë t'i gjesht ata, sepse janë të paktë ata që e dallojnë këtë aftësi tek vetvetja. Por ne tani i dallojmë ata.

A.K.: Kur fut dikë në biznes, që nga ai moment bëhet anëtar i familjes, dhe bëhet i yti me gjithë tiparet negative që ka.

A.V.: Por skuadra e re, menaxheri i ri ndikon tek ty, funksionon si forcë shtytëse.



As këtu nuk shani?

A.V.: Këtu kërkojmë dhe mbështesim. Duke dhënë besim. Rreptësia mund të shfaqet vetëm në tonin e zërit. U mësojmë metodën dhe u formojmë personalitetin. Duhet t'ua bësh të qartë vazhdimisht njerëzve pikësynimin e tyre, t'u sugjerosh që mund ta bëjnë dhe mund ta arrijnë. Sot janë të pakta familjet ku fëmijët marrin nxitjen që u nevojitet për të krijuar vetëbesimin e shëndetshëm. Njerëzit kanë shumë nevojë për përkujdesje.

A mund të plotësohet kjo në moshën e rritur?

A.V.: Mund të plotësohet kurdo. Shumica e tyre në fillim nuk kanë dëshirë të dalin as në skenë. Pastaj kur mësohen e pëlqejnë atë. Në sportet individuale kam qenë në Top 10 të Europës në vitin 1977.

Kurse këtu në Forever që nga viti 2005 jemi vazhdimisht në Top 10 të Europës falë punës së madhe të gurëve tanë të çmuar si diamant menaxherët **Veronika dhe Stevan Lomjanski**, diamant-safir menaxheri **Robert Varga**, soaring menaxherët **Editke dhe Istvan Kasa**, si dhe shumë menaxherë me kualitete të mëdha, të cilët për shkak të mungesës së vendit nuk kemi mundësi t'i përmendim, por i falenderojmë për punën e tyre. Folëm rreth paralelizimit me sportin, dhe nuk përmendëm se ku ia kalon kjo sportit profesionist. Në lojrat olimpike në majë të podiumit ka vetëm një vend për të cilin përpiqen shumë njerëz. Kurse këtu mund të lindin me qindra menaxherë. Në sport arrin rezultat të lartë një herë në vit, kurse këtu sa herë të duash. Dhe këtu mund ta ndryshoj jetën edhe një njeri 70 vjeçar.

Aranka, edhe ti ke patur ndrojtje nga skena?

A.V.: Do të kisha po të mos më thërrisnin aty. Njeriu nuk duhet të jetë i turpshëm në lidhje me sukseset e tij. Dhe unë jam krenare që përveç sportit kam arritur të siguroj edhe tre diploma të shkëlqyera. Këtë e arrita me tre stërvitje në ditë dhe një ngarkesë optimale. Jam shumë krenare për linjën time sponsorizuese: diamant-safir menaxheri **Miklos Berkics** (sponsorin ynë i shkëlqyer), safir menaxheri **Jozsef Szabo**, diamanti i trefishtë Kipp Rolf, drejtori gjeneral **Dr. Sandor Milesz** dhe presidenti-drejtori i përgjithshëm **Rex Maughan**. Shumë shpresëdhënëse, apo jo?

I keni ndërjerë periudhat e ndryshme gjatë 13 viteve që „ndërtoni” këtu?

A.K.: Pesë vitet e para krijuam një skuadër stabile që funksionon mirë, pastaj zhvillimi ishte i vazhdueshëm.



A.V.: Në gjysëm vitin e parë hodhëm bazat bashkë me nënën time, pastaj e arritëm relativisht shpejtë që gjithë familja të bëhej anëtare aktive e Forever-it. E kisha marrë vullin, kështu që nuk m'u duk e vështirë. Dhe në atë kohë nuk donim ta besonim që kjo gjë funksionon, sepse në firma të tjera na premtuan shumë gjëra, dhe jo gjithçka u realizua. Kurse këtu gjithçka funksionon siç duhet tashmë prej 13 vitesh: firma e mban çdo premtim të bërë. Çdo anëtar i Forever-it e di përshembull që çfarë do të thotë data pesëmbëdhjetë. Në vitin e parë u bëmë senior, në të dytin soaring, tre vjet më vonë safir, pastaj katër vjet më pas diamant-safir menaxherë, ndërkohë që çdo anëtar i skuadrës sonë u ngjiti gjithmonë e më lart.

A.K.: Këto kualifikime kanë qenë të gjitha momente të bukura, por momenti i parë me të vërtetë i paharrueshëm ishte mënyra se si na pritën njerëzit në teatrin Erkel. Nuk kishim bërë asgjë tjetër përveç detyrës sonë, dhe prapë na festonin. Kjo dashuri është e pabesueshme. Thonë që njeriu çdo tetë vjet duhet ta rinovoj vetveten. Por s'është kështu për një profesionist, ne bëmë gjithçka dhe u përpoqëm gjithmonë të jemi ndër më të mirët.

Çfarë pret nga viti i ardhshëm?

A.V.: Fillimisht rritje të lehtë, pastaj intensive.

Sigurisht, ke qenë gjithmonë shembulli i optimizimit...

A.V.: Dhe tani nuk jam aq optimiste. Këto janë procese të parashikuara, dhe në skuadër gjithçka është më e lehtë.

A.K.: Është mirë të jesh optimist, sepse atëherë s'ka gjë të pamundur. Këtu zhvillohet një punë e madhe, por sfidat janë reale.

Si mendoni për nivelin e diamantit? Si diçka që keni për ta zotëruar njëherë?

A.K.: E rëndësishme është puna në skuadër në mënyrë që të ketë rendiment dhe rritje

A.V.: Varet që çfarë pikësynimi ka firma. Përpiqemi që t'i përgjigjemi çdo sfide të Rex Maughan-it.

A.K.: Në madhështinë njerëzore të Rex Maughan-it – përveç faktit që drejton – e rëndësishme është ëndrra e tij sensacionale. Si njeri pati efekt të madh tek ne që nga momenti i parë. Të blej një ishull dhe të krijosh përsëri aty një pyll shiu: edhe kjo është një ëndërr. Nëpërmjet xhelit aloe t'i jap njerëzimit një lëndë e cila e fuqizon: kjo është gjithashtu një ëndërr.

Përmende që edhe fëmijët po ecin në rrugën tuaj. Mendoj se nuk „i detyruat“ ata.

A.V.: Detyrim jo, por mes teknikave të mia gjendet edhe një dhunë e lehtë. Pasi jam e bindur që do të jenë shumë të lumtur nëse punojnë këtu, të paktën si punë dytësore. Botond është 28 vjeç dhe menaxher, Xenia 21 vjeç dhe mbaroi shkëlqyeshëm shkollën e lartë, kurse Viginia 19 vjeç dhe tani u kthye nga Amerika ku bëri një shkollë komunikacioni. Po ta mendoj mirë, u krijuam një mundësi të pabesueshme fëmijëve gjatë dhjetë viteve të kaluara. Por është akoma më e rëndësishme fakti që janë fëmijë të mirë të cilët duan t'i ndihmojnë njerëzit.

Në të vërtetë mirëqenia materiale dhe reklamimi i saj duket si diçka dytësore për ju.

A.K.: Nuk ndodhet në qendër të vëmendjes. Edhe mes rrethanave të thjeshta kemi zhvilluar bisedime të mëdha; duhet të qëndrojmë në sinkron me mirëqenien në mënyrë që të na pranojë.

A.V.: Mardhëniet njerëzore dhe dashuria na çojnë përpara. Nga bursa e republikës popullore merrja njëmijë forinta, kurse për medaljen e bronzit në Kampionatin Botëror njëherë morra nëntë mijë. S'ishin këto për të cilat morra përsipër katër stërvitje në ditë. Kjo s'ka të bëjë aspak me paranë, dhe kështu është edhe në lidhje me Forever-in. Por meqë ekziston një mënyrë vlerësimi, mua më pëlqen të punoj për të marrë vlerësimin më të madh të mundshëm.

Me këtë dëshiron të tregosh vetveten diku?

A.V.: Sigurisht, përpara prindërve të mi. Për mua gjithmonë kryesorja ka qenë t'u shkaktoj gëzim atyre.

Si i ndani rolet në punë?

A.K.: Aranka është menaxherja logjistike e marketingut, u përgjigjet në mënyrë gjeniale pyetjeve racionale, kurse tek unë dominon ana emocionale, krahas të cilës u specializova edhe për pyetjet profesionale.

A.V.: Nuk do të ishim kaq të suksesshëm po të mos ndihmonim njëri tjetrin edhe kur nuk jemi së bashku, të cilën e bëjmë afërsisht prej dyzetë vitesh.

Si e trajtoni disfatën?

A.K.: Çfarë është disfata?

A.V.: Ka edhe të tilla. Suksesi dhe disfata janë vëllezër. Nuk mund të jesh gjithmonë i suksesshëm. Por çfarë quajmë të tillë? Ka patur rast që një lidhje tetëvjeçare është bërë supervizor ose menaxher, dhe pak njerëz e vlerësojnë këtë. Duhet këmbëngulje dhe përballje disfatash. Kjo gjë vendoset në kokë. Thuajti kokës që çfarë të bëj zemra, kurse zemra të thotë nga të shkojnë këmbët.

Me sa duket, juve ju ka çuar në drejtimin e duhur zemra.

A.K.: Unë e kam ditur gjithmonë, por nuk e kam ndjerë asnjëherë aq shumë sa në Rallyn Europian të Spanjës, ku ia përsërita dhjetë herë publikut që Rex Maughan-Rex Maughan, dhe në sytë e njeriut të madh u shfaq pika e lotit, pastaj më përqafoi. Ky përqafim ishte ndryshe nga të tjerët. M'u duk se më në fund i ktheva diçka.

A.V.: Kam besim tek puna kuptimplotë, pavarësia, fluturimi dhe veprimet e mia. Por rolin kryesor e luajnë menaxherët e vërtetë të skuadrës sonë, ata japin shembull në këmbëngulje, janë gurët e çmuar të përparimit tonë.







PROGRAMI NË INTERNET

23.9.-30.9.2010

- 18:00, 06:00** Forever film Forcë e trefishtë
18:35, 06:35 Dr. Milics Margit Shëndeti është thesari ynë kryesor, të kujdesemi për të!
18:55, 06:55 Dr. Bagoly Ibolya Më thuaj, çfarë do kërkoje nga jeta?
19:35, 07:35 Dr. Németh Endre Profiti është i imi!
20:00, 08:00 3 Graciat flasin Minutat e Sonya-s
20:20, 08:20 Lyn de Gara Sonya
21:05, 09:05 Siklósné dr. Révész Edit Raport 1
21:25, 09:25 Yjet e FLP-s, Pjesa I
21:55, 09:55 Dr. Samu Terézia Fushata verore Vitality
22:25, 10:25 Fekete Zsolt Dyfisho qarkullimin!
23:05, 11:05 Yjet e FLP-s Pjesa II
23:35, 11:35 Nagy Ádám, Belényi Brigitta Shqiponja në Rallyn Europian në Vienë
00:10, 12:10 Hajcsik Tünde Raport
00:25, 12:25 Szabó Péter Të bukurat e ndërtimit të skuadrës
00:45, 12:45 Klaj Ágnes U bëra anëtare e PC
01:05, 13:05 Dr. Zsolcai Sándor Aloe në praktikë, produktet e suksesshme të Forever-it
01:35, 13:35 Halmi István Raport
01:50, 13:50 Siklósné dr. Révész Edit Informacione të përgjithshme rreth aloe vera-s
02:15, 14:15 Vargáné dr. Juronics Ilona Përgatitje për vjeshtën
02:40, 14:40 Tóth Csaba Bazat e rrjetit
03:10, 15:10 Berkics Miklós Tre herë tetë
03:30, 15:30 John Curtis Edhe ti mund të shkëlqesh si Diamant!
04:25, 16:25 Jozó Zsolt, Molnár Judit Elementë motivues në FLP
04:50, 16:50 Halmi István Si drejtues në Forever
05:15, 17:15 Sebók Noémi U bëra menaxher në FLP
05:35, 17:35 Dr. Bagoly Ibolya Ushqimi

23.9.-21.10.2010

30.9.-7.10.2010

- 18:00, 06:00** Forever film, Forcë e trefishtë
18:35, 06:35 Siklósné dr. Révész Edit Raport (2)
18:50, 06:50 Rex Maughan Raport (Paczolay Klaudia)
19:10, 07:10 Berkics Miklós 13 vjet sukses
19:45, 07:45 Rex Maughan Minutat e Sonya-s pjesa 1-2
20:35, 08:35 Masazh me mjaltë, Higjenë
20:45, 08:45 Aidan O'Hare Grupi muzikor Android, konkursi Miss Sonya
21:40, 09:40 Michael Strachowitz Tre çelësat e suksesit
22:40, 10:40 Halmi István Zgjero!
23:30, 11:30 Raportime nga World Rally
00:25, 12:25 Berkics Miklós Ju jeni më të mirët
01:05, 13:05 Aidan O'Hare FLP Europa
01:30, 13:30 Papp Tibor, Papp Tiborné Puna në skuadër
02:30, 14:30 Minutat e Sonya-s pjesa 3-4-5
02:55, 14:55 Higjenë, trajtim flokësh, trajtim lëkure, Sonya Skin Care
03:10, 15:10 Veronika Lomjanski
03:35, 15:35 Sonya – Android
04:05, 16:05 Minutat e Sonya-s pjesa 6
04:10, 16:10 Fleur de Jouvence
04:35, 16:35 Berkics Miklós Minutat e Sonya-s pjesa 7-8-9
04:45, 16:45 Scrub, Marine Mask, Epiblanç
04:50, 16:50 Dr. Gothárd Csaba Unë mësoj, ti mëson, ne zhvillohemi
05:35, 17:35 Váradí Éva Përse jemi të aftë

7.10.-16.10.2010

- 18:00, 06:00** Katrin Bajri
19:00, 07:00 Forever film Forcë e trefishtë
19:40, 07:40 Tóth Csaba Po punoj për Profit Sharing
20:30, 08:30 Kocsis Imre Të gjithë kanë një ëndërr
21:10, 09:10 Vesza Zsóka Punë skuadre
21:35, 09:35 Budai Tamás Teknika të ndërtimit të biznesit
22:05, 10:05 Tonk Emil Merre seriozisht!
22:45, 10:45 Dr. Gothárd Csaba Çfarë u bëre Tokë e shtrenjtë?
23:05, 11:05 Minutat e Sonya-s pjesa 10
23:10, 11:10 Lojë me ngjyrat
23:30, 11:30 Zsiga Márta Bota e mrekullueshme e Forever-it
23:35, 11:35 Minutat e Sonya-s pjesa 11-12
23:35, 11:35 Sonya Colour Collection, Bazë
00:05, 12:05 Berkics Miklós Forever është e ardhmja jote
00:05, 12:05 Tonk Emil Trainim menaxherësh
00:30, 12:30 Jan Mary Lurel
01:40, 13:40 Halmi István FLP sipas këndvështrimit tim
02:05, 14:05 Dr. Tombáczné Tanács Erika Jeto momentin!
02:30, 14:30 Dr. Taraczkózi István Mënyrë jetese e natyrshme – Duaje vetveten
02:45, 14:45 Ráth Gábor Shkalla e parë e sistemit marketing
03:15, 15:15 Tóth Sándor Kërkim blerësish dhe konsumatorësh, teknika biznesi
03:45, 15:45 Minutat e Sonya-s pjesa 13 Paletë ngjyrash
03:50, 15:50 Prezantim Sonya
04:10, 16:10 Hajcsik Tünde NDP, meriton më shumë
04:50, 16:50 Biró Tamás Heronjtë tanë
05:20, 17:20 Veronika Lomjanski Edhe unë kam qenë supervisor
05:50, 17:50 Minutat e Sonya-s pjesa 15-16
05:55, 17:55 R3 Factor, Alluring Eyes
05:55, 17:55 Szabó József Lojalitet ndaj firmës

16.10.-21.10.2010
DITË SUKSESI NON-STOP





EUROPEAN & WORLD RALLY VIENNA 2011

AUSTRI, VIENË 15-16 PRILL 2011

Periudha e kualifikimit: 1 korrik deri në 31 tetor

NIVELI 3

Plotësoni 95 CC (bashkë me pikët personale) me skuadrën tuaj të re

- ★ BILETA HYRJE NË RALLY
- ★ 3 NETË NË HOTEL
- ★ UDHËTIMI ME AVION



NIVELI 2

Plotësoni 50 CC (bashkë me pikët personale) me skuadrën tuaj të re


- ★ BILETA HYRJE NË RALLY
- ★ 3 NETË NË HOTEL



NIVELI 1


Plotësoni 20 CC (bashkë me pikët personale) me skuadrën tuaj të re

- ★ BILETA HYRJE NË RALLY



Kushtet e reja të kualifikimit për në çdo nivel: Sponsorizoni të paktën tre distributor të gjeneratës së parë të cilët arrijnë nivelin e Assistant Supervisorit. Çdo distributor i ri duhet të arrijë vlerat e pikëve të dhëna në figurë.

I kualifikuari të jetë "Aktiv" në çdo muaj të periudhës së kualifikimit. Periudha e kualifikimit zgjat nga 1 korrik 2010 deri më 31 tetor 2010, gjatë kësaj periudhe duhen plotësuar gjithë kushtet e kualifikimit. Distributorët e rinj duhen regjistruar gjatë periudhës së kualifikimit, dhe ndërmjet tyre ai që dëshiron të kualifikohet duhet të jetë aktiv që në muajin e hyrjes. Data e hyrjes është ajo e regjistrimit të të dhënave të tij në sistemin kompjuterik të kompanisë qëndrore. Në këtë program motivues kanë vlerë vetëm blerjet e bëra brenda rajonit. Çdo distributor i linjës së poshtme duhet të zotërojë adresë brenda rajonit. Çdo distributor mban përgjegjësi për kuptimin e duhur të kushteve të programit motivues. S'ekziston mundësia e trajtimit të veçantë. Programi motivues përmban vetëm kushtet dhe shpërblimet e shfaqura në figurë. Për çdo pyetje që keni drejtohuni drejtorit tuaj gjeneral. Shpërblimet nuk mund të shkëmbehen në para dhe shpërblimet nuk mund t'u jepen të tjerëve.



Tregohu kurreshtar!

Këto rreshta nuk do i lexoje po të mos konsumoje produktet e shkëlqyera të FLP-s, ose po të mos kishe një njeri të tillë në jetën tënde i cili ta sjell ty këtë revistë. Ai është korieri i lajmit që deri tani nuk e ke dëgjuar ose nuk ke dashur ta dëgjosh.

Kjo letër ju drejtohet atyre që nuk e kanë marrë akoma vendimin, që dëshirojnë një jetë më të mirë, më të ekuilibruar, më të lumtur.

Atyre të cilët jo vetëm dëshirojnë por janë edhe të gatshëm për të vepruar. Atyre të cilët dëshirojnë që fëmijët e tyre të jetojnë jetën tani „të mundshme”, jetën të cilën ke ëndërruar për ata dhe veten tënde! Të pyes me sinqeritet. Ti që nuk i ke shtrënguar akoma dorën njeriut të cilit ia di për faleminderit që tani po lexon këto rreshta. PËRSE PO PRET? Kur do e pyesësh se çfarë duhet të bësh që në këtë situatën e sotme të pasigurt, që ndryshon shpejt dhe u shkakton dëshpërim njerëzve, edhe Ti të mund të jetosh jetën që jetojnë njerëzit të cilët falë biznesit Forever i jetojnë (dhe jo mbijetojnë) ditët e tyre në siguri, qetësi dhe pa probleme materiale? Unë këtë stil jete pash tek njerëzit të cilët kanë ndihmuar dhe e ndihmojnë akoma deri më sot ndërtimin e biznesit tim. Për ta mendova se mund të ndihmojnë këdo që të jetoj jetën e tyre shembullore. Falenderoj (unë dhe shumë të tjerë) Andras Banhidny-n për qëllimshmërinë, Gabriella Dominko-n për patjen në qendër të vëmendjes zhvillimin e personalitetit të njeriut, Klara Hertelendy-n për maksimalizmin, Hajnalka Senk-un për vrullin, Dr. Adolf L. Kosa-n për profesionizmin dhe Tamas Biro-n për mënyrën e të menduarit, si rrjedhim i të cilave m'u realizua jeta që kam dashur të jetoj gjithmonë. Dhe që u krijua një skuadër ku gjendjen ndjekës të denjë.

Mos m'u përgjigj mua, por vetvetes: nuk e beson që ky biznes funksionon

me të vërtetë, dhe mund të jetë me të vërtetë rrugëzgjdhje për problemet aktuale në jetën tënde? Apo nuk e beson që edhe ti e meriton këtë jetë dhe je i aftë për të?

Nëse nuk beson tek e para, jam i sigurt që kjo vjen vetëm nga mungesa e informacioneve.

Është e vështirë të lexosh yjet e Pyllit në një libër me faqe bosh, apo jo? Por nëse libri i ka faqet plot nga fillimi deri në fund në mënyrë që ta shijosh dhe ta kuptosh gjithë historinë, duke qarë dhe qeshur së bashku me personazhet, atëherë do ta kesh më të lehtë për ta vendosur që të pëlqen apo jo kjo vepër.

Po sikur këtë libër ta kenë shkarravitur plotësisht? Aq sa i gjithë libri bëhet i palexueshëm, s'mund të lexosh dot asnjë fjalë?

Ti kë do lejoje ta shkarraviste librin? Nëse asnjërin, atëherë përse lejon që opinionin i të tjerëve të formoj jetën tënde dhe „shkarravitjet” e të tjerëve të ndotin shikimin tënd?

Po të them që fshirësen e ka në dorë njeriu i cili të ndihmoi të lexosh këtë revistë. Lutju të të marrë me vete në një aktivitet, prezantim të hapur, Ditë Sukses, trainim. Lutju të të prezantoj tek njerëz, interesi moral dhe material i të cilëve është që t'i të bësh shumë para prej këtij biznesi! Kërkoji gjithë materialet informative që të ndihmojnë në sqarimin e pyetjeve të tua pa përgjigje. Për këtë ekzistojnë CD, DVD, prospekte, publikime zyrtare dhe libra të shkëlqyera të firmës. Tregohu kureshtar!

Mblidh informacione derisa „të fshini” gjithçka që kishte mbuluar informacionin e pastër origjinal.

Dhe nëse nuk beson tek e dyta, pra tek vetvetja, që edhe ti e meriton këtë

jetë, atëherë në radhë të parë të lutem që mos beso tek vetvetja, por tek ata që e kanë ndërtuar këtë biznes dhe do të ndihmojnë edhe ty për këtë.

Në radhë të dytë të lutem që shiko tani në pasqyrë dhe thuaj me zë të lartë: „Më vjen keq, por nuk më besohet që mund ta krijoj dot jetën që dëshiron, dhe nuk besoj që e meriton atë.” Si e ndjen veten? – nuk duhet të përgjegjesh...

Kam dëgjuar në një film:

„Ka nga ata që kanë frikë nga fakti që mund të jetojnë edhe ndryshe dhe që bota nuk është aq e keqe. Ka nga ata që mësohen aq shumë me gjërat, edhe me gjërat e këqija, saqë nuk guxojnë t'i ndryshojnë ato. Këta njerëz dorëzohen. Dhe nëse ata dorëzohen, të gjithë humbasin.”

Ta dish që nga vendimi yt do të fitojnë edhe njerëz të tjerë që ndodhen rreth teje. Fito që të fitojnë edhe të tjerët. Ndoshta vendimi yt do të ndryshojë edhe jetën e një njeriu tjetër. Ose jetën e shumë njerëzve!

Unë besoj akoma në të ardhmen e bukur, ku vlerat njerëzore, ndihma e njëri tjetrit, dëshira për të vepruar, optimizmi, respekti ndaj njëri tjetrit, vlerësimi dhe dashuria e drejtojnë botën.

Të shkruajmë një kapitull tjetër bashku me ty në librin e sukseseve të Forever-it. Një kapitull i cili flet rreth Teje, të cilin e shkruan Ti, ku ëndrrat e Tua bëhen realitet. Nga i cili marrin forca edhe të tjerët.

Borbala Szekely
Menaxhere





Liri e kthjellët

„Nëse lufton, mund të humbasësh, nëse nuk lufton, ke humbur.”

Historia jonë e Forever-it filloi kur mjekja ime familjare Dr. Judit Fazekas na dha një kartë blerësi të përhershëm. Pastaj me kalimin e disa muajve, në janar të 2010-ës ra zilha e telefonit dhe një grua atëherë akoma e panjohur për mua, në emër të sponsores sime më ofroi ndihmë në lidhje me produktet. Atëherë vajza jonë ishte 5 vjeç kurse djali 3 muajsh, kështu që isha shumë e lidhur. U çudita shumë

kur ajo për takimin e të hënës paradite u përgjigj kështu: „Në orën 10 mbaroj stërvitjen Pilates dhe pastaj mund të takohemi.” Pasi ula telefonin filloi të më punonte truri. Kjo është diçka të cilën edhe unë e dëshiroj shumë: LIRIA. Në mjedisin tim njoh shumë njerëz të cilët jetojnë në kushte të mira materiale. Por me thënë të drejtën asnjëherë nuk i kam patur zili, sepse shumica e tyre nuk e zotërojnë kohën e nevojshme

për shijimin e të mirave materiale, pasi janë robër të punës në biznesin e tyre ose si rrjedhim i punës së madhe dhe të vazhdueshme kanë humbur shëndetin e tyre. Sakrifikuan rininë për të hedhur bazat e sfondit të tyre material, kurse tani një pjesë të mirë të parave të siguruara i shpenzojnë për të rifituar shëndetin. Ky për mua nuk është një shembull që dëshiroj ta ndjek, sado të mira materiale që mund të sjellë.





Por kur e kuptova që kjo grua – Erika – është një grua që zotëron kohë të lirë, dhe patjetër edhe sfondin material, m'u duk se ky takim mund të më ndryshoj jetën. I thashë që burrit tim që me çfarëdo merret kjo grua, atë kam për ta bërë edhe unë në mënyrë që ta arrij këtë liri.

Por në takim u përballa menjëherë me vështirësinë e parë që atëherë dukej e pakapërcyeshme: arritja e nivelit 2 pikësh të biznesit. Maksimum për dy muaj! Mendoja që kjo është e pamundur. Jo për dy muaj, por as për dy vjet nuk mund ta arrij dot qarkullimin me vlerën 140000 Ft në kartën time! Pastaj e arrita që të nesërmen si rezultat i bashkimit të rrethit të ngushtë familjar. Problemi im tjetër ishte që FLP funksionon me sistemin MLM, dhe ashtu si shumë të tjerë këtu në Hungari, edhe unë nuk kisha opinion të mirë rreth kësaj forme tregëtie. Por pastaj duke kapërcyer pengesat e mia fillova të mbledh informacione korrekte nga njerëz të besueshëm në lidhje me marketingun në rrjet. Sepse përshembull edhe makinën nuk e çojmë tek bukëpjekësi kur duam ta rregullojmë... Kur sigurova informacionet e duhura më erdhi turp që kisha krijuar opinion për një gjë të cilën nuk e njihja aspak më parë. Sot tregëtinë në rrjet e konsideroj si një nga format më të ndershme dhe më korrekte të tregëtisë, pasi këtu

suksesi yt varet nga fakti se sa dëshirë dhe mundësi ke të ndihmosh të tjerët. Burri im është inxhinier ndërtimi, aktualisht punon si drejtues ndërtimi në një firmë, kurse unë para lindjes së fëmijëve tanë punoja si juriste, gjithashtu si nëpunëse. Ndoshta nuk ishim në vendin e duhur në momentin e duhur, por në punët tona të deritanishme nuk ishin këto kushtet e përparimit...

4 pikët personale në muaj i arritëm pa i vënë re. Na pëlqente aq shumë që mund të ndihmojmë të tjerët, sa që e morrëm vesh nga mentori ynë që i plotësuam pikët.

Por 25 pikët i vumë re... Majin e mbyllëm me 7,801 pikë, kështu që kishim shumë për të bërë në qershor. Mentori ynë në aktivitete na prezantonte si çifti që në këtë muaj plotësojnë 25 pikët. E ndjeja keq veten, mendoja vetëm që sa turp do të ishte po të mos i arrinim. Pastaj një natë, në 18 qershor, kur i vumë në gjumë të dy fëmijët, u ulëm bashkë me burrin dhe rishikuam planet që kishim përgatitur me Erikën. Ata kishin besim tek ne dhe e dinin që jemi të aftë për këtë. Vetëm ne duhet të besonim në vetvete. Në këtë kohë na mungonin akoma edhe 11 pikë. Vendosëm të realizojmë një nga pikësynimet më të mëdha të jetës sonë në këtë muaj. Atë natë diçka ndryshoi. Kishim një plan dhe një motivim që

na sundonte krejt. Që nga ai moment edhe ne ishim të sigurt që mund t'i bënim 25 pikët në qershor, dhe kështu ndodhi. Asnjëherë s'kemi për ta harruar ndihmën e madhe që morrëm deri në fund nga mentorët tanë Erika Lupsa Mussone dhe Jozsef Musso. Si anëtar i kësaj skuadre kemi për ta shijuar edhe rrugën që na çon drejt arritjes së nivelit të menaxherit, edhe nëse nuk është e lehtë.

I gëzohemi shumë edhe faktit që shokët e skuadrës dhe konsumatorët tanë, Adel, Katika, Jolika dhe prindërit e mi, si dhe të tjerët patën besim tek ne.

Ne, krahas vajzës sonë të vogël tani rrisim edhe djalin tonë 10 muajsh, të cilën e bëj akoma kryesisht unë. Nuk është e vështirë ta imagjinosh se në rrethana të tilla nuk ishte dhe nuk është aspak e lehtë të gjesh kohë për t'u marrë me biznesin FLP.

Sot jemi të lumtur që atëherë nuk zgjodhëm rrugën më të lehtë dhe nuk nxorrëm pretekste, por duke përshkuar rrugën më të vështirë donim dhe duam të gjejmë rrugëzgjdhje për ndërtimin e biznesit tonë dhe nëpërmjet kësaj të arrijmë lirinë e dëshiruar. Pasi njeriu prandaj jeton, që pjesën më të madhe të kohës ta kalojë me të dashurit dhe familjen e tij pa halle dhe i lirë?

Dr. Reka Nagy Kovacsne
supervizore



Gjatë punës sonë takohemi me të njohur – dhe jo me pak – të cilëve kur u tregojmë mundësitë e ofruara nga ndërtimi i rrjetit na kthejnë shpinën, nuk i shfrytëzojnë ato, nuk e konsiderojnë këtë një punë serioze. Por kjo punë është me të vërtetë serioze, po aq serioze sa edhe puna që kryen një murator, një jurist apo një bukëpjekës – e do radhisja mëtej edhe profesione të tjera. Ndërtimi i rrjetit është shkencë, përbërësit e së cilës mund të përvetësohen. Nuk mund të theksohet aq sa duhet që: mësim dhe vetëm mësim, sepse suksesin nuk mund t'ia lemë në dorë rastësisë. Jeta jonë nuk është një llotë ku ose „na ecën” ose jo! Duhet të drejtojmë vetë atë.



Më shumë se 11 vjet më parë u njoha me firmën Forever, që atëherë mësoj dhe më duket gjithmonë e më shumë se kam akoma për të mësuar. Ndërtimi i rrjetit duket i thjeshtë dhe i realizueshëm, prandaj hyjnë shumë njerëz në këtë sistem. Por një pjesë e tyre e humbet vrullin. Ku është gabimi? Si sponsor detyra jonë është të ndihmojmë kandidatët e rinj që ta kuptojnë, ta mësojnë dhe ta përdorin siç duhet metodën.

CILAT JANË SHKAQET KRYESORE QË LËKUNDET DIKUSH?

1. nuk e kupton plotësisht mundësinë që i ofrojnë
2. nuk „e kupton” sistemin e ndërtimit të rrjetit
3. nuk e kupton thelbin e tij, prandaj
4. nuk „ka besim tek ai”, kështu që
5. as nuk përpiqet ta përvetësojë atë

Çështje e njohur apo? Nuk e keni kuptuar akoma thelbin, ndiheni të turbulluar në mendje. Dhe njeriu kur është i turbulluar nuk bën asgjë, prandaj duket sikur është dembel. Turbullimi e mposht besimin në vetvete, mund të themi edhe që ky është „kanceri” i ndërtimit të rrjetit!

Si mund ta luftojmë „kancerin”? Me fuqizimin e besimit në vetvete. Rriten gjenerata të tëra në mënyrë të tillë që nuk e zhvillojnë aspak këtë tipar shumë të rëndësishëm dhe të nevojshëm në çdo fushë të jetës. Gjatë ndërtimit të rrjetit kemi një ndihmës (të cilin e quajmë sponsor) interesi dhe përgjegjësia e të cilit është fuqizimi i besimit në vetvete të kandidatit të ri. Sponsor është si treneri personal i cili punon që njerëzit të mësojnë aftësitë e nevojshme për shpërndarjen e produkteve dhe sponsorizimin në mënyrë të tillë që ta kryejnë me siguri këtë punë dhe të mbeten akoma të motivuar në fund të ditës. Ushtrimi i çdo veprimtarie dhe profesioni është rezultat i një

procesi mësimor. Asnjëri nuk lind informaticien, marangoz, apo që di të ngasë makinën, biçikletën apo të notoj. Çdo gjë mund të arrihet me mësim, dhe kjo është e vërtetë edhe për ndërtimin e rrjetit.

ÇFARË ËSHTË AJO QË MUND TË PËRVETËSOHET?

1. çfarë duhet të mësojmë (dituri)
2. çfarë duhet të bëjmë (aftësi)
3. çfarë duhet të ndjejmë (qëndrim)

Në rastin e sponsorizimit përshembull duhet të njohim pikët e prezantimit të mundësisë së biznesit, duhet t’u përgjigjemi pyetjeve të shpeshta, e kështu mëtej. Çfarë duhet të bëjmë, me fjalë të tjera si duhet të ftojme dikë, si duhet ta bëjmë prezantimin e biznesit, si duhet të pyesim për vendimin... Çfarë duhet të ndjejmë, me fjalë të tjera: të tregohemi të zellshëm, të shpejtë, të përpiktë, të besueshëm, të pyesim për gjithçka dhe të mos i paragjykojmë kandidatët tanë! Kjo nuk është „një detyrë që e zgjedhim vetë”, kjo duhet përvetësuar! Në intres të suksesit duhet ta mësojmë dhe duhet ta bëjmë. Më kujtohen fjalët e Miki Berkics-it: „Suksesi nuk ka sekret – suksesi ka çmim!” Sigurisht, si gjithçka tjetër në jetë. Dhe tregëtari i suksesshëm e paguan çmimin: mëson, mëson, mëson, zhvillohet! Edhe kandidatët tanë e ndjejnë kur nuk jemi „në formë”, kur nuk dimë çfarë të themi apo çfarë të bëjmë. Mungesa e vetëbesimit tonë ndikon edhe në vetëbesimin e tyre. Dhe nëse e ndiejnë këtë, „turbullohen”, dhe çfarë bën një distributor i turbulluar? – ASGJË!

Duhet t’i tregosh vetvetes që i ke përvetësuar njohuritë e duhura: këtu s’ka provim si në shkollë, por s’ka as presion! Ti je vetë komisioni i provimit. Testo vetveten – shpejt ose ngadalë – si të duash. Mund ta fillosh aq herë që ke dëshirë, nëse mashtron, atëherë mashtron vetveten. Kurse treneri yt

personal të ndihmon derisa e shikon që ke nevojë për ndihmën e tij. Nëse testin e njohurive e bërë me sukses, më pas duhet të vërtetosh që je i aftë të arrish rezultate, pasi njohuritë e mbetura në nivelin teorik nuk sjellin pikë. Nëse e siguron patentën dhe pastaj nuk e nget makinën – a mund të thuash që di të ngasësh makinë? Na ndihmon shumë nëse me çdo kandidat të ri e shikojmë së bashku procesin e mësimi, sepse kjo gjë i qetëson ata, e kuptojnë që ku kryejnë gabime.

MËSIMI ËSHTË NJË PROCES ME KATËR HAPA.

1. Takohesh me gjëra të reja dhe nuk e di akoma se çfarë duhet të bësh.
2. Fillon të mësosh dhe dallon gjërat që nuk di. Praktikoni!
3. „Jep provim” me sukses – mban prezantimin tënd të parë, bën akoma shumë gabime, duhet ta kesh shumë mendjen që kur vepron dhe çfarë bën – duhet të përqëndrohesh.
4. Ke aq shumë përvojë saqë nuk mendon aspak që çfarë duhet të bësh. Gjithçka të është bërë rutinë.

Suksesi i mësimi bazohet në 3 karakteristika:

Praktika: Çdo aftësi mësohet pas një radhe përpjekjesh dhe gabimesh. Nuk gabon vetëm ai që nuk bën asgjë. Durimi: Mësimi kërkon gjithmonë shumë kohë. Edhe një marangozi i duhen 3 vjet për të mësuar zanatin, mjeku kalon shumë vite në universitet. Tregohu i duruar me kandidatit tënd dhe bëji të ditur që edhe ai të tregohet i duruar me vetveten. Këmbëngulja: Në interes të suksesit duhet ta provosh përsëri, përsëri dhe përsëri!

U uroj gjithë distributorëve shëndet dhe fuqi për këtë detyrë të bukur.

Maria Marko
senior menaxherë



E dashur Shqiponjë e Re!

Të përsëhendes me respekt dhe dashamirësi Ty që në muajt e fundit (ose edhe më herët) hyre në të ardhmen tënde, por tani kjo verë të frymëzon të nisesh në një rrugë të planifikuar, të nisesh biznesin tënd të shkëlqyer Forever, ku fiton pavarësi jo vetëm për tre-katër javë por për gjithë jetën tënde. Bëhu Ti i pari i cili e përgëzon veten për vendimin tënd! E di që ke patur dhe ke dyshime, pyetje të papërgjigjura, me raste edhe ti bëhesh i pasigurt, me siguri të kanë ofruar edhe të tjerë oferta që ngjajnë si MLM të cilat janë „jashtëzakonisht të mira, madje më të mirat” – s’ka problem. Kjo ka vite që është kështu dhe kështu do të mbetet. Por nga mund ta dish që ti je anëtar i vërtetë i Forever-it? Njihbu mirë me faktet 32 vjeçare të Forever-it dhe shtoi atyre besimin që ke në vetvete – do të shohësh një rezultat të mahnitshëm!

Që në moshë të vogël më pëlqente shumë shtatori, muaji kur kam lindur – në këtë muaj marr dhuratat më të shumta. Në këtë muaj në skenë do të ngjiten shumë njerëz, nga të cilët shtatori gjithashtu do të pëlqehet shumë – u poq fruti i punës së verës, erdhi momenti i vlerësimit.

Gjatë muajve të fundit shumë të rinj dhe të vjetër u ngjitën në nivel më të lartë. Në jetën e një fillestari të Forever-it rezultati më i madh është vendimi që nuk dëshiron të mbetet me dy pikë. Fillon të punoj me njerëz, të krijoj skuadër dhe të bëj “luftën e pavarësisë” të parë dhe më të rëndësishme në jetën e tij. Brenda disa muajve bëhen menaxherë dhe shembuj të cilët do të ndiqen. Ata janë kolegët tanë Supervisor, për të cilët jemi shumë krenar. Ky nivel është një lloj “provimi maturie”. Nëse njëherë për njëherë dëshiron të qëndrosh në këtë nivel, edhe këtë e vendos ti, do të kesh të ardhura mbi mesataren – por më e rëndësishmja: ke siguri, sepse mësove të ndërtosh rrjet, “i ke letrat për ta vazhduar kurdo shkollimin e mëtejshëm”.

Më kujtohen fjalët e sponsorit tim Dr. Sandor Milesz kur i emocionuar, i prekur dhe me shumë krenari mezi prisja të më thërrisnin në skenë bashkë me partneren time Dr. Ilona Gurka, dhe të na kualifikonin si Supervisor. Sandori pasi më dha medaljen më tha: “përgëzime për arritjen e nivelit më të rëndësishëm.” Më erdhi mirë që u vlerësova nga njeriu i cili nuk është vetëm sponsor dhe mik, por shembulli ynë i vërtetë – por në vetvete atëherë kujtoja se më të rëndësishmet ishin 120 pikët e menaxherit. Jo. Sandori kishte të drejtë. Supervisorin ndërton nga asgjëja një botë të re. Për arritjen e nivelit të menaxherit krahas njohurive të supervisorit nevojiten vetëm ëndrra më të mëdha, por nga ana teknike është me të vërtetë më e lehtë – në këtë rrugë ke konsumatorë të rregullt, shumë dy pikësh, katër-pesë kandidatë për Supervisor – ke një skuadër të zellshme që përpiqet për më lartë, dhe je ti, Supervisorin që ndjekin nga pas.

Ju që jeni akoma Asistent Supervisor, çlirohuni sa më parë nga titulli Asistent. Ky është një nivel i bukur dhe i rëndësishëm, pasi këtu fillon gjithçka – por ju këtë e arritët, s’keni më punë me të. Pyesni sponsorët dhe drejtuesit tuaj që cilët u bënë Supervisor kohët e fundit në skuadrën tuaj. Njihuni me ta dhe jepuni dorën. Do ta ndjeni që e keni ju radhën.

TIBOR RADOCZKI
SOARING MENAXHER,
DREJTOR RAJONAL





ju mirëpret Juve dhe familjen tuaj në aktivitetin

DITA E SHËNDETIT

më 17-18 shtator 2010

DATA DHE ORARI:

17. shtator 2010, ora 12.00-20.00,

18 shtator 2010, ora 10.00-20.00.

VENDI I ORGANIZIMIT:

Budapest V. ker., Szabadság tér

EKZAMINIME DHE KËSHILLA FALAS:

matje e peshës së trupit dhe indeksit të peshës së trupit, matje e nivelit të sheqerit dhe yndyrave në gjak, ekzaminim i zembrës dhe sistemit të qarkullimit të gjakut, përcaktimi i nivelit të stresit, ekzaminimi i parametrave funksional të sistemit të frymëmarrjes, ekzaminimi i gjendjes së sistemit lokomotor në bazë të matjes së presionit të shputës.

NË AKTIVITETIN TONË FAMILJAR JU MIRËPRESIM ME PROGRAME ARGËTUESE, PROGRAME FËMIJËSH, LEKSIONE INFORMATIVE ME TEMË RUAJTJEN E SHËNDETIT, PREZANTIME DHE PANAIR PRODUKTESH!

DISA PREJ LEKTORËVE:

DR. MÁRAI GÉZA

(docent universiteti)

DR. BAKANÉK GYÖRGY

(mjek specialist gjinekolog dhe sporti, këshilltar mënyre jetese),

DR. TARACZKÓZI ISTVÁN

(kryetar i Shoqatës Hungareze të Mjekëve Popullor, mjek popullor me titullin Pro Vita et Natura)

DISA PREJ ATYRE QË DO TË SHFAQEN:

TÚRI LAJOS – LUI

DANCESTYLE

SÁRI ÉVI

BERECZKI LAJOS

MINIKONCERT I GRUPIT ANDROID

KONCERT I SASVÁRI SÁNDOR

në bashkëpunim me **MAHÓ ANDREA**

RIEBERGER ANITA

BÁNYÓCZKY NÓRA

APOKRIF

HUNGARICUM

DEEZEL


KORDA GYÖRGY DHE BALÁZS KLÁRI

STARLICHT DANCE

STUDIOJA E KËRCIMIT PIRUETT

SURPRIZË ME MYSAFIRË TË NJOHUR

Programi dhe informacione më të hollësishe gjenden në: www.egeszsegnap.eu



FOREVER 
IMRPRESSUM

Botues: Forever Living Products Hungari Shpk. **Redaksia:** FLP Hungari Shpk. 1067 Budapest, Szondi u. 34. Telefon: (36-1) 269-5373 Fax: (36-1) 312-8455

Kryeredaktor: Dr. Sandor Mílesz **Redaktor:** dr. Csaba Gothárd, Valeria Kismarton, Zsuzsanna Petroczy, Kalman Posa, Sandor Rokas,

Layout, përgatitje për shtypje: Crossroad Consulting Shpk. **Koordinator projekti:** Szilvia Timar **Redaktor leximi:** Zita Kempf **Korrigjues:** Ildiko Kiraly **Redaktor projekti:** Raden Hannawati

Fotograf: Robert Laszlo Bacsí **Përkthim, redaktim:** Dr. Marsel Nallbani (shqip), Babity Gorán Vladimír, Žarko Anić Antić (kroat), Ortilia Toth-Kasa, Balazs Molnar, Dragana Meseldžija (serb), Jolanda Novak Csaszar, Biro 2000 Ljubljana (sloven).

Shtypshkronja: Palatia Nyomda és Kiadó Shpk. U përgatit në 30500 kopje.

Për përmbajtjen e artikujve përgjegjësia është e autorëve. Çdo e drejtë mbrohet!

www.foreverliving.com



Aloe Sunscreen Spray

Nëse ju dhe familja juaj zhvilloni një jetë aktive, duhet të jeni gjithmonë të përgatitur. Ju duhet të jeni gjithmonë gati për të vepruar nëse dëshironi që gjithë familja të jetë e lumtur. Kështu që nëse përgatiteni të kaloni jashtë kohën tuaj të lirë, s'keni shkak për t'u shqetësuar.

Prandaj mbani gjithmonë me vete Aloe Sunscreen Spray. Ky produkt me mbrojtjen prej 30 faktorësh dhe përmbajtjen e Aloe Vera-s e mbron lëkurën nga efektet e dëmshme të diellit, dhe falë qëndrueshmërisë së madhe në ujë mund të laheni dhe të notoni pa problem. Vetëm një shtypje butoni dhe mund të nisni banjon e diellit! Lëkura e shëndetshme në verë s'ka qenë asnjëherë kaq e thjeshtë!

PËRBËRËSIT

Aloe Barbadensis Leaf Juice (Stabilized Aloe Vera Gel), Water (Aqua), Homosalate, Ethylhexyl Salicylate, Phenylbenzimidazole Sulfonic Acid, Propanediol, Butyl Methoxydibenzoylmethane, Diethylhexyl Carbonate, Butyloctyl Salicylate, Octocrylene, Polyester-7, Styrene/Acrylates Copolymer, Neopentyl Glycol Diheptanoate,

Acrylates/C12-22 Alkyl Methacrylate Copolymer, Cetareth-25, Acrylates Copolymer, Phenoxyethanol, Disodium Ethylene Dicapamide PEG-15 Disulfate, Triethanolamine, Pentylene Glycol, Disodium EDTA, Panthenol, Fragrance (Parfum), Tocopheryl Acetate, Methylisothiazolinone, Citronellol, Geraniol, Hexyl Cinnamaldehyde, Alpha-isomethyl Ionone.

MËNYRA E PËRDORIMIT

Përpara përdorimit duhet trazuar! 15-30 minuta para banjos së diellit vendoseni në lëkurë në sasi të bollshme dhe në mënyrë të njëtrajtshme. Mos e hidhni drejtpërdrejt në fytyrë, por lyeni atë me kremën e marrë në dorë. Përdoreni përsëri produktin pas notit ose nëse e ndjeni lëkurën të thatë. Në rastin e fëmijëve me moshë nën 6 muajsh kërkoni mendimin e mjekut.



- Faktori i lartë (30) mbrojtës nga dielli ofron me efekt mbrojtje nga gjithë spektri i rrezatimeve UVA dhe UVB.
- Qëndrueshmëri e madhe në ujë
- Paketim komfort në formë spray